

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
PER RREGJISTRIMIN E SHOQERISE

“HERA” Sh.p.k.

Sot, me date 7/6/ 2007, une M. Dajpa, gjyqtare ne
Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen per rregjistrimin e Shoqerise
“HERA” Sh.p.k. paraqitur nga Administratori Zana Vokopola dhe;

KONSTATOVA SE:

Me Aktin e Themelimit date 25.05.2007, Rep.6283, Kol.1012, dhe Statutin date 25.05.2007,
Rep.6284, Kol.1013, Zana Vokopola, ka themeluar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar “HERA”
Sh.p.k.

Emërtimi i Shoqërisë është “HERA” Sh.p.k.

Forma e Shoqerise “HERA” Sh.p.k., eshte “Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar”, Sh.p.k. e cila sipas ligjit
per Shoqerite Tregtare, perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

Selia e Shoqërisë eshte ne Tirane, Rruga “Reshit Petrela”, Sek.1, kati 9, Ap.D. Shoqëria mund të
ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në
Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose
me vendim të ortakut të vetëm.

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë dhe jashte saj,
gjithashtu ajo mund te krijojë dege, filiale, ose perfaqesi, ne rrethe te ndryshme te Republikës se
Shqipërisë apo ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatase.

Objekt i Aktivitetit te Shoqerise eshte:

- Prodhimin e furnizimin ne sektorin e energjise elektrike, nepermjet kryerjes se investimeve ne kete fushe.
- Importimin dhe Eksportimin, me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te pajisjeve dhe lendeve te para dhe ndihmese, te nevojshme per realizimin e pikes 6.1 te objektit te aktivitetit te shoqerise.
- Nese per fillimin e ushtrimit te nje apo me shume prej aktiviteteve te mesiperme, me Ligje apo aktet nenligjore kerkohet pajisja me license, Shoqëria eshte e detyruar te pajiset me licensen perkatase perpara fillimit te atij aktiviteti dhe te permbushe te gjitha kerkesat ligjore.

Kapitali i Shoqerise është 100.000leke(njeqindmije). Ai është ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera me vlerë te barabarte 1.000 leke secila, të renditura sipas numrave nga 1 deri në 100.

Pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise “HERA” Sh.p.k., zoterohen nga Ortaku i Vetem Zana Vokopola.

Kapitali i Shoqërisë është 100.000 leke (njëqind mijë). Ai është ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera me vlerë të barabartë 1.000 leke secila, të renditura sipas numrave nga 1 deri në 100.

Pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë "HERA" Sh.p.k., zotërohen nga Ortaku i Vetem Zana Vokopola.

Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetem Zana Vokopola, duke u depozituar në Banke.

Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetem. Emërimi i administratorit bëhet për një periudhë pa afat, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i Shoqërisë emërohet Zana Vokopola, e cila është edhe Ortak i Vetem i Shoqërisë. Ajo emërohet dhe do të qëndrojë në këtë detyrë për një periudhë pa afat.

- Urdhërohet zyra e regjistrimit tregtar të bëjë veprimet përkatëse.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit.

GJYQATAR
Mogelminda Dippo
Dippo

SHOQERIA TREGTARE
"HERA" SH.P.K.
Date 03.07.2007

V E N D I M

Nr.1

I Ortakut te Vetem te Shoqerise
"HERA" SH.P.K.



Sot me date 03.07.2007, Ortaku i Vetem i Shoqerise "HERA"Sh.p.k, e regjistruar me vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr.38491, date 07.06.2007, me Seli, ne Tirane, Rr. Reshit Petrela, Seksioni 1, Kati 9, Ap.D, me kapital themeltar 100.000Leke, i cili zoteron 100.000 te kapitalit te kesaj Shoqerise, ne lidhje me rendin e dites:

- Rritjen e kapitalit themeltar te Shoqerise "HERA"Sh.p.k, duke kontribuar ne shumen 12.200.000Leke.

Ortaku i Vetem i Shoqerise "HERA"Sh.p.k, pasi shqyrtoi ne teresi çeshtjen e rendit te dites,

V E N D O S I:

1. Te rrise vleren e kapitalit themeltar te Shoqerise "HERA"Sh.p.k, duke kontribuar ne shumen 12.200.000Leke(dymbedhjetemilioneqindmije). Vlera prej 12.200.000Leke, per rritjen e kapitalit themeltar, i shtohet shumes ekzistuese te kapitalit themeltar prej 100.000leke.
2. E gjithe shuma prej 12.200.000Leke, eshte derdhur/shlyer plotesisht me kontributin e Ortakut te Vetem te shoqerise, znj. Zana Vokopola, e vlefshme per rritjen e kapitalit te shoqerise "HERA"Sh.p.k", fakt i cili vertetohet nga Banka Kombetare Tregtare "BKT" nepermjet Vertetimit nr.192 protokolli, date 02.07.2007.
3. Si rezultat i rritjes se kapitalit themeltar, nenet 10.1 dhe 12.1, te Statutit te Shqerise "HERA"Sh.p.k, ndryshojne dhe behen si vijon:
 - NENI 10.1: Kapitali themeltar i Shoqerisë është 12.300.000Leke(dymbedhjetemilioneqindmije).
 - NENI 12.1 Kapitali themeltar me vlere 12.300.000Leke, është i ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera, secila me vlerë te barabarte prej 123.000Leke(njeqindenjzetetremije) dhe të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe duhet te depozitohet ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE "HERA" SH.P.K.
Zana Vokopola

Zana Vokopola
Vokopola

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 8977 Rep.



Nr. 1422 Kal. 14



VERTETIM

Sot, në Tirane, me datë 03.07.2007, perpara meje, Noterit Agim Xh. Robo, anetar i Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalish, Zana Vokopola, shtetase shqiptare, lindur me 22.08.1965, banuese ne Tirane, Bulevardi "Bajram Curri", Pall 23, Ap.7, me pasaporte Z0536678, madhore me zotesi te plote per te vepruar, për identitetin e te cilit u sigurova nga dokumentet identifikuese qe ai mban, e cila ne cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise "HERA"Sh.p.k., me vullnetin e saj te lire dhe te plote, nenshkroi Vendimin e Ortakut te Vetem bashkengjitur ketij vertetimi, dhe Une Noteri e vertetoj kete sipas ligjit.

NOTER





Banka Kombetare Tregtare
Dega Stacioni Trenit Tirane
Nr. Prot 192

Tirane me 02 korrik 2007

VERTETIM

**Vertetojme se Zj. Zana Vokopola ka derdhur ne llogarine e “ Hera “
shpk me numer llogarie 421139420, shumen prej 12.200.000 lek
(Dymbedhjetmilionedyqintmije) lek me qellim per rritjen e kapitalit
E leshojme kete vertetim me kerkesen e te interesuarit.**

Drejtor I deges
Erkid Veizi



Në bazë të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Mbi Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare”,

V E N D O S A:

Pranimin e kërkesës dhe depozitimin e Akteve të Shoqërisë “HERA”Sh.p.k, në Zyren e Regjistrimit Tregtar përkatësisht të:

- Vendimit të Ortakut të Vetem të Shoqërisë datë 03.07.2007, me të cili është vendosur:
 1. Rritja e vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë “HERA”Sh.p.k, duke kontribuar në shumën 12.200.000Leke(dymbëdhjetemilionedyqindmije). Vlera prej 12.200.000Leke, për rritjen e kapitalit themeltar, i shtohet shumës ekzistuese të kapitalit themeltar prej 100.000leke.
 2. E gjithë shuma prej 12.200.000Leke, është derdhur/shlyer plotësisht me kontributin e Ortakut të Vetem të shoqërisë, znj. Zana Vokopola, e vlefshme për rritjen e kapitalit të shoqërisë “HERA”Sh.p.k”, fakt i cili vërtetohet nga Banka Kombëtare Tregtare “BKT” nëpërmjet Vërtetimit nr.192 protokollit, datë 02.07.2007.
 3. Si rezultat i rritjes së kapitalit themeltar, nën 10.1 dhe 12.1, të Statutit të Shoqërisë “HERA”Sh.p.k, ndryshojnë dhe behen si vijon:
 - NEN10.1:Kapitali themeltar i Shoqërisë është 12.300.000Leke(dymbëdhjetemilionetreqindmije).
 - NENI 12.1 Kapitali themeltar me vlerë 12.300.000Leke, është i ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera, secila me vlerë të barabartë prej 123.000Leke(njëqindnjëzetetremije) dhe të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100.

Urdhëroj Zyren e Regjistrimit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse.

Kunder këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

GJYQTARE




REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 6283 Rep.

Nr. 1012 Kol. 12

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR



Sot, ne Tirane, me date 25/5/2007, para meje Noterit Agim Xh. ROBO, noter i Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalisht,

Zana Vokopola, shtetase shqiptare, lindur me 22.08.1965, banuese ne Tirane, Bulevardi "Bajram Curri", Pall 23, Ap.7, Tirane, me pasaporte Z0536678, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar i cili themelon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar, "HERA" Sh.p.k., ne te cilen eshte Ortak i Vetem dhe per kete qellim harton Aktin Themelimit te saj, me permbajtje si vijon:

NENI 1
EMRI

- 1.1 Shoqëria eshte me pergjegjesi te kufizuar dhe emertohet "HERA" Sh.p.k., e cila kudo ketu e më poshtë do te quhet "Shoqëria".

NENI 2
FORMA

- 2.1 Kjo Shoqeri eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

NENI 3
BAZA LIGJORE

- 3.1 Shoqëria krijohet në baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e Akteve te saj. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 4
SELIA

- 4.1 Selia e Shoqërisë eshte ne Tirane, Rruga "Reshit Petrela", Sek.1, kati 9, Ap.D. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 5

TERRITORI

- 5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 5.2 Shoqëria mund të krijojë dege (filiale) ose perfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 6 OBJEKTI I AKTIVITETIT TE SHOQERISE

- 6.1 Prodhimin e furnizimin në sektorin e energjisë elektrike, nëpërmjet kryerjes së investimeve në këtë fushë.
- 6.2 Importimin dhe Eksportimin, me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve të pajisjeve dhe lendeve të para dhe ndihmese, të nevojshme për realizimin e pikës 6.1 të objektit të aktivitetit të shoqërisë.
- 6.3 Nëse për fillimin e ushtrimit të një apo me shumë prej aktiviteteve të mesipërme, me Ligje apo aktet nënligjore kërkohej pajisja me license, Shoqëria është e detyruar të pajiset me licencën përkatëse përpara fillimit të atij aktiviteti dhe të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore.

NENI 7 KOHEZGJATJA

- 7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 8 KAPITALI THEMELTAR

- 8.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 Leke (njëqindmije).
- 8.2 Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakut i vetëm. Shoqëria mund ta shtojë ose zvogelojë kapitalin, në varesi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

NENI 9 KONTRIBUTET

- 9.1 Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i Ortakut të Vetem të Shoqërisë Zana Vokopola me vlerë 100.000 Leke, shumë e cila është depozituar në Banke.

NENI 10 PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

- 10.1 Kapitali themeltar është i ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera, secila me vlerë 1000 Leke, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100.

NENI 11 ADMINISTRIMI



- 11.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator i Vetem.
- 11.2 Emërimi i administratorit bëhet për nje periudhe pa afat, me te drejte rizgjedhje.
- 11.3 Administratori i Shoqërisë emerohet Zana Vokopola, e cila eshte edhe Ortak i Vetem i Shoqerise. Ajo emerohet dhe do te qendroje ne kete detyre per nje periudhe pa afat.

NENI 12
DISPOZITA TE FUNDIT

- 12.1 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Akt Themelimi, do te zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi per Shoqerite Tregtare.
- 12.2 Ky Akt Themelimi mund te ndryshohet plotesisht ose te ndryshohet pjeserisht me Vendim te Ortakut te Vetem, ne perputhje me ligjin ne fuqi.
- 12.3 Ky Akt Themelimi, hartohet ne ne 5 kopje origjinale ne gjuhen shqipe me vlere te njejte.
- 12.4 Autorizohen Av.Alfred Mustafa, anetar i dhomes se Avokateve Tirane me licence nr.650 dhe z.Denis Demiri, mbajtes i pasaportes nr.Z0225233, per ndjekjen e procedures se regjistrimit te kesaj Shoqerie prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 12.5 Ky Akt Themelimi hartohet në 5 (kater) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me fuqi të njëjtë ligjore.

Une Noteri ia lexova me ze te larte themeluesit tekstin e ketij Akti Themelimi dhe Ai deklaroi se e kupton dhe se eshte hartuar ne perputhje te plote me vullnetin e tij te lire, pasi e nenshkruan rregullisht ne prezencen time, une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

THEMELUESI DHE ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

"HERA"
Zana Vokopola

Zana Vokopola
Vokopola

Tirane me 25.05.2007.



Noteri
Alfred Mustafa
650

[Signature]

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“HERA” Sh.p.k

NENI 1 THEMELUESI



- 1.1 Themelues i Shoqerise eshte Ortaku i vetem Zana Vokopola, shtetase shqiptare, lindur me 22.08.1965, banuese ne Tirane, Bulevardi “Bajram Curri”, Pall 23, Ap.7, madhore me zotesi te plote per te vepruar, me pasaporte Z0536678.
- 1.2 Shoqëria eshte me pergjegjesi te kufizuar dhe emertohet “HERA” Sh.p.k., e cila kudo ketu e më poshtë do te quhet “Shoqëria”.

NENI 2 FORMA

- 2.1 Kjo Shoqeri eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

NENI 3 BAZA LIGJORE

- 3.1 Shoqëria krijohet në baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij Statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 4 SELIA

- 4.1 Selia e Shoqërisë eshte ne Tirane, Rruga “Reshit Petrela”, Sek.I, kati 9, Ap.D. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 5 TERRITORI

- 5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 5.2 Shoqëria mund të krijojë dege (filiale) ose perfaqesi, si ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 6 OBJEKTI I AKTIVITETIT TE SHOQERISE

- 6.1 Prodhimin e furnizimin ne sektorin e energjise elektrike, nepermjet kryerjes se investimeve ne kete fushe.
- 6.2 Importimin dhe Eksportimin, me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te pajisjeve dhe lendeve te para dhe ndihmese, te nevojshme per realizimin e pikes 6.1 te objektit te aktivitetit te shoqerise.
- 6.3 Nese per fillimin e ushtrimit te nje apo me shume prej aktiviteve te mesiperme, me Ligje apo aktet nenligjore kerkohet pajisja me license, Shoqeria eshte e detyruar te pajiset me licensen perkatese perpara fillimit te atij aktiviteti dhe te permbushe te gjitha kerkesat ligjore.

NENI 7
KOHEZGJATJA

- 7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar me përjashtim të rastit të mbarimit të saj, sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 8
LIBRI I SHOQERISE

- 8.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

NENI 9
DOKUMENTAT E DESTINUAR PER TE TRETET

- 9.2 Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

NENI 10
KAPITALI THEMELTAR

- 10.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000Leke (njëqindmije).
- 10.2 Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm. Shoqëria mund ta shtojë ose zvogeloje kapitalin, ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

NENI 11
KONTRIBUTET

- 11.1 Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i Ortakut te Vetem te Shoqerise Zana Vokopola me vlere 100.000Leke, shume e cila eshte depozituar ne Banke.

NENI 12
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

- 12.1 Kapitali themeltar është i ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera, secila me vlerë 1000Leke, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100.

NENI 13
LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT



- 13.1 Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortaku i vetëm vendos për këtë. Ai mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rruge trashëgimie. Bashkeshortja, paraardhësit dhe pasardhësit mund të behen ortak nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, me vendim të ortakut të vetëm dhe sipas kushteve që lejohen në ligj.
- 13.2 Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të behen me akt noterial.

NENI 15
ORTAKU I VETEM

- 15.1 Ortaku i Vetem ushtron i vetem të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe ky Statut.

NENI 16
KOMPETENCAT E ORTAKUT TË VETEM

- 16.1 Ortaku i Vetem ka të drejtë të ushtroje kompetencat si vijojnë:
- Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektore të veçanta të veprimtarisë.
 - Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit dhe transferimin e pjesëve të kapitalit.
 - Vendos për politiken tregëtare të Shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
 - Emeron dhe shkarkon administratorin/ret dhe detajon kompetencat e tij/tyre të përcaktuara në Statut dhe sipas rastit emerion dhe shkarkon Eksepertrin Kontabel.
 - Kur e shikon të nevojshme emerion drejtorin ekzekutiv të Shoqërisë apo të sektoreve të veçanta të saj, duke caktuar në aktin e emerimit edhe kompetencat e tij, kohezgjatjen në punë etj.
 - Shqyrton bilanci vjetor, përcakton llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos për marrjen e kredive.
 - Vendos për krijimin e degeve (filialeve) ose të perfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjere fizike apo juridike.
 - Vendos për marrëdhëniet me të rëndësishme ekonomike dhe financiare të Shoqërisë me persona të tjere fizike apo juridike, vendas apo të huaj.
 - Vendos për mbarimin e Shoqërisë, likuidimin e saj si dhe për shndërrimin e Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera.
 - Vendos për shitblerjen e Pasurive të Paluajtshme dhe vendosjen e garancive hipotekore mbi to.
 - Vendos për marrjen dhe dhenien e huave dhe të kushteve të tyre.

NENI 17
ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

- 17.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetëm.
- 17.2 Emërimi i administratorit bëhet për një periudhë pa afat, me të drejtë rizgjedhje.
- 17.3 Administratori i Shoqërisë ushtron kompetencat si vijojnë:
- Realizon administrimin, drejtimin dhe perfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhëniet me persona e trete juridike apo fizike.
 - Perfaqëson Shoqërinë në kryerjen e të gjithë veprimeve të nevojshme përpara të gjitha Organeve të Administratës Shtetërore dhe atyre Gjyqësore.
 - Nenshkruan Kontrata dhe Marreveshje të të gjitha llojeve dhe për çdo lloj shume, me kusht që të mos tejkalojë kompetencat apo shkelë kufizimet që e vendosura nga Ligji apo Statuti i Shoqërisë.



- Hap Llogari bankare ne emer te shoqerise dhe kryen te gjitha llojet e veprime dhe operacioneve bankare me to.
- Kujdeset per funksionimin e perditeshem normal te Shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet per shqyrtim Ortakut te Vetem.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri.
- Shqyrton ofertat dhe pergatit kerkesa te cilat ia paraqet Ortakut te Vetem per miratim.
- Ndjek problemet e Shoqerise ne marredhenie me organet shteterore.
- I propozon Ortakut te Vetem te Shoqerise çmimet e shitjes dhe te sherbimeve si dhe pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.
- I propozon Ortakut te Vetem rregulloret per sektore te veçante te Shoqerise.
- Vendors per çmimet e shitjes se sherbimeve etj.
- Vendors per pagat e te punesuarve ne Shoqeri.

17.4 Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

NENI 18 BILANCI

- 18.1 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor të çdo viti.
- 18.2 Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortaku, miratohen nga ortaku i vetëm.
- 18.3 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 19 DIVIDENTET

- 19.1 Ortaku i vetem miraton llogaritë vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit. Ai percakton fitimin e vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat per rezerven e detyrueshme nga ligji ose te percaktuar nga vete ortaku; fondet e tjera qe shihen te nevojshme si dhe i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme.

NENI 20 PRISHJA

- 20.1 Shoqëria prishet me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

NENI 21 LIKUJDIMI

- 21.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimi që në momentin kur Ortaku i Vetem ka vendosur prishjen e saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimi dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.
- 21.2 Në fund të procesit të likujdimi, ortaku i vetëm vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimi. Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.



NENI 22
ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

- 22.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

NENI 23
DISPOZITA TE FUNDIT

- 23.2 Shoqëria do të ketë vullnet e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Ortaku i Vetëm.
- 24.3 Administrator i Shoqërisë emërohet Zana Vokopola e cila është edhe Ortake e Vetme e Shoqërisë. Ajo emërohet dhe do të qëndrojë në këto detyra për një periudhë pa afat.
- 24.4 Ky Statut është hartuar në 5 (pese) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
"HERA"
ZANA VOKOPOLA

Zana Vokopola
Vokopola

Tirane me 25.05.2007.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE


Nr. 6284 Rep.

Nr. 1013 Kol. 15

VERTETIM

Sot, në Tirane, më datë 25.05.2007, përpara meje, Noterit A. Pogo,
anetar i Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalish, Zana Vokopola, shtetase shqiptare,
lindur me 22.08.1965, banuese ne Tirane, Bulevardi "Bajram Curri", Pall 23, Ap.7, me
pasaporte Z0536678, madhore me zotesi te plote per te vepruar, për identitetin e te cilit u
sigurova nga dokumentet identifikuese qe ai mban, e cita ne cilesine e Themeluesit dhe
Ortakut te vetem te Shoqerise "HERA"Sh.p.k., pasi ka miratuar permbajtjen e Statutit te saj,
bashkengjitur ketij vertetimi, me vullnetin e tij te lire dhe te plote e nenshkroi ate rregullisht
përpara meje e dhe Une Noteri e vertetoj kete sipas ligjit.

NOTER

A. Pogo




38481

KERKESE



J. M. Dajge
dt. 28.05.2007

[Signature]

28 MAG 2007

KERKUES: Administratori i Shoqerise Tregtare, ne rregjistrim e siper "HERA" Sh.p.k., znj. Zana Vokopola, shtetase shqiptare, lindur me 22.08.1965, banuese ne Tirane, Bulevardi "Bajram Curri", Pall 23, Ap.7, Tirane, me pasaporte Z0536678.

OBJEKTI: Rregjistrimin e Shoqerise "HERA" Sh.p.k., dhe depozimin e akteve te saj ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

BAZA LIGJORE: Neni 59 i ligjit 7667, date 28.01.1993, "Per rregjistrin Tregtar dhe formalitetet te duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Perpara
GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

*Statuti, akti themelues
Ata maren vete dt 28/5/07
e bangles BKT.
Enam me
4/6/2007*

Me Aktin e Themelimit date 25.05.2007, Rep. 6283, Kol. 1012, dhe Statutin date 25.05.2007, Rep. 6284, Kol. 1013, Themeluesja dhe Ortakia e vetme, Zana Vokopola, ka themeluar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "HERA" Sh.p.k., ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Emertimi i Shoqerise eshte "HERA" Sh.p.k.

Forma e Shoqerise "HERA" Sh.p.k., eshte "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" Sh.p.k. e cila sipas ligjit per Shoqerite Tregtare. perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, Rruga "Reshit Petrela", Sek.1, kati 9, Ap.D. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te ortakut te vetem.

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar, me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara ne ligj me vendim te ortakut te vetem.

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, gjithashtu ajo mund te krijojte dege, filiale, ose perfaqesi, ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise apo ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatase.

Objekt i Aktivitetit te Shoqerise eshte:

- Prodhimin e furnizimin ne sektorin e energjise elektrike, nepermjet kryerjes se investimeve ne kete fushë.
- Importimin dhe Eksportimin, me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te pajisjeve dhe lendeve te para dhe ndihmese, te nevojshme per realizimin e pikes 6.1 te objektit te aktivitetit te shoqerise.
- Nese per fillimin e ushtrimit te nje apo me shume prej aktiviteteve te mesiperme, me Ligje apo aktet nenligjore kerkohet pajisja me license, Shoqeria eshte e detyruar te pajiset me licensen perkatase perpara fillimit te atij aktiviteti dhe te permbushe te gjitha kerkesat ligjore.

Kapitali i Shoqerise eshte 100.000leke(njeqindmije). Ai eshte ndare ne 100 pjesë plotësisht të shlyera me vlerë te barabarte 1.000 leke secila, të renditura sipas numrave nga 1 deri në 100.

[Signature]

Pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise "HERA" Sh.p.k., zoterohen nga Ortaku i Vetem Zana Vokopola.

Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, jane nënshkruar dhe shlyher plotësisht nga Ortaku i Vetem Zana Vokopola, duke u depozituar ne Banke.

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i Vetem. Emërimi i administratorit bëhet për nje periudhe pa afat, me të drejtë rizgjedhje.


Administratori i Shoqërisë emerohet Zana Vokopola, e cila eshte edhe Ortak i Vetem i Shoqerise. Ajo emerohet dhe do te qendroje ne kete detyre per nje periudhe pa afat.

PER SHOQERINE TREGETARE

"HERA" Sh.p.k.,

Administratori

Zana Vokopola

Handwritten signature of Zana Vokopola in cursive script.


Tirane me 25.05.2007

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 6285 Rep.
Nr. — Kol.

VERTETIM

Sot. në Tiranë, me datë 25.05.2007, përpara meje, Noter A. Robo, anetar i Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalish, Zana Vokopola, shtetase shqiptare, lindur me 22.08.1965, banuese ne Tirane, Bulevardi "Bajram Curri", Pall 23, Ap.7, me pasaporte Z0536678, madhore me zotesi te plote per te vepruar, për identitetin e te cilit u sigurova nga dokumentet identifikuese qe ai mban, e cila ne cilesine e Administratores se vetme te Shoqerise "HERA" Sh.p.k., me vullnetin e saj te lire dhe te plote nenshkroi kerkesen bashkengjitur, drejtuar Gjykates per rregjistrimin e kesaj shoqerie dhe Une Noter e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

A. Robo




12

J. E. Lleshi
dt. 04.07.2007

04 Lug. 2007



KERKESE

Te depozitohet behesa

KERKUES: Administratori i Shoqerise Tregetare, ne rregjistrim e siper "HERA" Sh.p.k., znj. Zana Vokopola, shtetase shqiptare, lindur me 22.08.1965, banuese ne Tirane, Bulevardi "Bajram Curri", Pall 23, Ap.7, Tirane, me pasaporte Z0536678.

OBJEKTI: Depozitim e Vendimit te Ortakut te Vetem date 03.07.07, te Shoqerise "HERA" Sh.p.k., per rritjen e kapitalit te saj, ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

dhe detyrues kombetare

BAZA LIGJORE: Neni 59 i ligjit 7667, date 28.01.1993, "Per rregjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

*- vendim nr 1, dt 03.07.2007
i ortakut te vetem,*

Perpara
GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

- vendim nr 2 Prot, dt 02.07

Shoqeria "HERA" Sh.p.k, eshte person juridik shqiptar i regjistruar me vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr.38491, date 07.06.2007, me Seli, ne Tirane, Rr. Reshit Petrela, Seksioni 1, Kati 9, Ap.D.

i Benhet kombetare Tregtare

Me Vendimin e dates 03.07.2007, rep. 8477, Ortaku i Vetem i Shoqerise "HERA" Sh.p.k, znj. Zana Vokopola, ka vendosur:

dt 16.07.2007

1. Te rrise vleren e kapitalit themeltar te Shoqerise "HERA" Sh.p.k, duke kontribuar ne shumen 12.200.000Leke(dymbedhjetemilionesqindmije). Vlera prej 12.200.000Leke, per rritjen e kapitalit themeltar, i shtohet shumes ekzistuese te kapitalit themeltar prej 100.000leke.
2. E gjithë shuma prej 12.200.000Leke, eshte derdhur/shlyer plotesisht me kontributin e Ortakut te Vetem te shoqerise, znj. Zana Vokopola, e vlefshme per rritjen e kapitalit te shoqerise "HERA" Sh.p.k", fakt i cili vertetohet nga Banka Kombetare Tregetare "BKT" nepermjet Vertetimit nr.192 protokolli, date 02.07.2007.
3. Si rezultat i rritjes se kapitalit themeltar, nenet 10.1 dhe 12.1, te Statutit te Shoqerise "HERA" Sh.p.k, ndryshojne dhe behen si vijon:
 - NENI10.1:Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 12.300.000Leke(dymbedhjetemilionesqindmije).
 - NENI 12.1 Kapitali themeltar me vlere 12.300.000Leke, eshte i ndare ne 100 pjesë plotesisht të shlyera, secila me vlerë te barabarte prej 123.000Leke(njeqindenjzetetremije) dhe të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe duhet te depozitohet ne Rregjistrin Tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

011/2007

Ulione Lleshi

Bazuar ne sa me mesiper, kerkojme:
Depozitim e Vendimit te Ortakut te Vetem date 03.07.07, te Shoqerise "HERA" Sh.p.k., per rritjen e kapitalit te saj, ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

PER SHOQERINE TREGETARE
"HERA" Sh.p.k..
Administratori
Zana Vokopola

Tirane me 03.07.2007

Zana Vokopola

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 8178 Rep.
Nr. _____ Kol.

NOTE
TIRANE

VERTETIM

Sot, në Tirane, me datë 03.07.2007, perpara meje, Noterit Agim Xh. Robo, anetar i Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalish, Zana Vokopola, shtetase shqiptare, lindur me 22.08.1965, banuese ne Tirane, Bulevardi "Bajram Curri", Pall 23, Ap.7, me pasaporte Z0536678, madhore me zotesi te plote per te vepruar, për identitetin e te cilit u sigurova nga dokumentet identifikuese qe ai mban, e cila ne cilesine e Administratores se Shoqerise "HERA"Sh.p.k., me vullnetin e saj te lire dhe te plote, nenshkroi Kerkesen bashkengjitur ketij vertetimi, drejtuar Gjykates per depozitimin e ndryshimeve te akteve te kesaj shoqerise, dhe Une Noteri e vertetoj kete sipas ligjit.

NOTERI
AGIM XH. ROBO

Agim Xh. Robo



TIRANE 29-MAY 2007



MARREVESHJE

**NGA BANKA KOMBETARE TREGETARE
DEGA STACIONI TRENIT TIRANE**

**DHE perfaqesuesi SHPK HERA.(ne krijim e siper)
Zotit...ZANA VOKOPOLA.**

Me objekt

Rregjistrimin juridik te fondeve te depozituara per llogari te shoqerise SHPK HERA (ne krijim e siper) .

- 1. Perfaqesuesi depoziton prane deges se B.K.T. shumen prej 100.000 (Njeqintmije). ALL ose , per llogari te shoqerise ... SHPK HERA (Ne krijim e siper).**

Kjo shume do te rrije e bllokuar ne kete llogari jo me teper se 1 muaj (afat brenda se ciles Gjykata eshte e detyruar ligjerisht te vendose ne lidhje me kerkesen e aplikimit) deri sa nga ana e tij te paraqitet ndermjet gjithë dokumentacionit te kerkuar nga banka vendimi I rregjistrimit ne gjykate .

Dega e B.K.T. pranon depozitimimin e shumes se mesiperme , duke I dhene depozituesit certifikaten e depozitimimit te fondeve me qellim qe te paraqese ate ne gjykaten perkatese.

- 2. Ne raste se perfaqesuesi kerkon te terheqe shumen e siperpermendur pa paraqitur dokumentacionin e kerkuar me siper duhet te ktheje mbrapsht certifikaten origjinale qe I eshte dhene atij per ta paraqitur ne gjykate.**
- 3. per sherbimin qe banka do te kryeje , do te zbatohen komisionet sipas;:**
 - 1500 leke per SH.P.K. me kapital kryesisht shqipetar**
 - 5 Usd per shoqeri te perbashket SH.P.K. me kapital te huaj ,pavaresisht nga raportet qe kane perqindjet e kapitalit te pasurive .**
- 4. Kjo marreveshje nenshkruhet ne dy kopje , prej te cilave sejcila nga palet merr nga nje.**

PERFAQESUESI

**DEGA B.K.T. STACIONI TRENIT
DREJTORI I DEGES**

